



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS

Shtëpia e Sporteve, rr. Agim Ramadani Nr 43, zyra nr 7, Prishtinë

Cell: +377 44 156 150

e-mail: info@fppk.com

www.fppk.com

THIRRJE PUBLIKE për dizajnimin e logos së FPPK-së

Federata e Pingpongu e Kosovës, aktivitetet e saj i kryen në tërë territorin e Kosovës si dhe është anëtare me të drejta të plota në mesin e të gjitha federatave tjera të botës në: Federatën Botërore të Pingpongu (ITTF - International Table Tennis Federation), dhe në Unionin Europian të Pingpongu (ETTU - European Table Tennis Union).

Nga muaji janar i vitit 2021, Federata e Pingpongu të Kosovës e ka në fuqi Statutin e ri të saj, i cili është akti më i lartë qeverisës i Federatës.

Në përputhje me nenin 16 të Statutit, Federata e Pingpongu e Kosovës është në kërkim të ideatorëve për dizajnimin e logos së re. FPPK-ja është e hapur për çdo individ dhe kompani që dëshiron të aplikoj.

Kriteret themelore teknike janë si vijon:

1. Të reflektojë misionin e Federatës së Pingpongu të Kosovës;
2. Të reflektoj sportin e pingpongu ku mund të përfshihen: tavolina, rrjeta, reketi, topi etj;
3. Logoja preferohet të përmbaj ngjyrat si në vijim: *(kaltër, kuq, verdhë, bardhë, dhe zi)*;
4. Të jetë bashkëkohore dhe e lehtë për t'u mbajtur mend;
5. Të jetë kuptimplotë. Aplikuesi duhet të paraqesë së bashku me logon edhe një tekst shpjegues të saj;
6. Të mos ketë ngjashmëri me asnjë nga logot e federatave të pingpongu të shteteve të tjera dhe të entiteve të tjera sportive në Kosovë dhe në botë;
7. Të jetë praktike dhe e përshtatshme për t'u përdorur në të gjitha materialet e Federatës së Pingpongu të Kosovës: uniformave të ekipeve përfaqësuese të Kosovës, materialeve promovuese, dokumentacion zyrtar, e të tjera.

RREGULLAT E KONKURIMIT:

1. Dizajnet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë:
 - Punimet e printuara dhe në CD në formë elektronike.
 - Punimet duhet të mbajnë vetëm një kod/shifër identifikuese dhe jo të dhënat personale të autorit.
 - Të dhënat personale të autorit të cilat duhet të futen në një zarf tjetër të vogël. Zarfi do të hapet vetëm pas përzgjedhjes së logos.

- Dizajnet duhet të punohen në programe të specializuara për dizajn si Adobe Photoshop, Adobe Illustrator, etj.
- Një autor mund të aplikojë me më shumë se një ide por jo më shumë se tri.
- Nëse një autor do aplikojë me më shumë se një ide, idetë duhet të paraqiten në zarfa të veçantë.
- Punimet e printuara konkurruese me CD duhet të vendosen në një zarf i cili duhet të përmbajë edhe zarfin e mbyllur me shënimet personale të autorit.

Punimet dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur me shënimet e mëposhtme në:

- Federata e Pingpongut e Kosovës
Shtëpia e Sporteve, rr. Agim Ramadani Nr 43,
Zyra nr 7, Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Në zarf duhet të shënohet:

- Për: Federatën e Pingpongut të Kosovës

Vlerësimi do të bëhet nga Komisioni profesional brenda Federatës së Pingpongut të Kosovës. Modeli ideor me numrin më të lartë të pikëve të fituara do të fitoj çmimin në vlerë prej **300 euro**.

Konkursi do të jetë i hapur nga data: 08 shkurt 2021 deri me datë me 1 mars 2021.

Rezultati do të publikohet në faqen zyrtare të FPPK-së në: www.fppk.com